



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"

Procedurë Prokurimi për Ofrimin e Shërbimit të Kateringut për Fëmijët gjatë Aktiviteteve Sportive "Ekipet Sportive në Shkollë".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 01.03.2025 - 15.06.2025 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Ftojme individët/ekipet/kompanitë me eksperience të provuar në shërbimin e kërkuar të cateringut që është i interesuar të bashkëpunojë për të angazhuar në aktivitetet e KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Njësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Organizim catering gjate organizimeve pergjate ndeshjeve te kampionatit	Catering per Femijet	Sanduic	Cope	Max 170 leke/cope pa Tvsh	12.000.000	Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”.	3 muaj ne disa Qarqe sipas kalendarit te ndeshjeve te miratuara nga Ekipet Sportive.

4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilesi të këtij shërbimi, do të kontaktohet individi, ekipi apo kompania që do të paraqesë ofertën më të mirë në përputhje me kushtet teknike dhe financiare të përcaktuara në këtë dokument. Metodologjia e ndjekur do të përfshijë:

- **Identifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik** përmes një procesi transparent dhe konkurrues;
- **Hartimin e nje plani te detajuar logjistik**, në bashkëpunim me kalendarin e miratuar nga projekti “Ekipet Sportive në Shkolla”, për të siguruar shërbimin në kohë dhe me cilesi në çdo qark;
- **Koordinimin me strukturat vendore dhe organizatoret e eventeve** për të përcaktuar pikat e shpërndarjes, numrin e pjesëmarrësve dhe oraret;
- **Monitorimin e cilesise se shërbimit te ofruar** gjatë gjithë periudhës së zbatimit, përmes feedback-ut nga terreni dhe raporteve të vazhdueshme;
- **Zbatimin rigoroz te standardeve te sigurise ushqimore**, duke siguruar që çdo vakt të jetë i përshtatshëm për fëmijë dhe në përputhje me normat higjieno-sanitare.

Kohezgjatja e këtij shërbimi është 4 muaj dhe do të mbulojë disa qarqe sipas kalendarit zyrtar të ndeshjeve të miratuara nga Ekipet Sportive në Shkolla.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

5. Kualifikimet e nevojshme

Kualifikimet:

- Te kete eksperience te meparshme per organizimin e eventeve te ngjashme kulturore dhe sportive.
- Te ofroje sherbimin e kerkuar sipas kerkesave nga KOKSH.
- Te paraqese oferten sipas kerkeses nga ne.
- Sigurimi dhe shpërndarja e ushqimeve.
- Permiresimi i pervojes se pjesemarrjes se nxenesve ne aktivitete sportive duke siguruar ushqim te sigurt, te shendetshem dhe te pershtatshëm per femijet gjate zhvillimit të ndeshjeve dhe eventeve.
- Ofertuesi duhet të jetë i licencuar për shërbime ushqimore/catering.
- Aftësia logjistike për shpërndarje në disa qytete njëkohësisht.

Për të qenë i përshtatshëm për këtë prokurim, ofertuesi duhet të plotesoje keto kriteret kualifikuese:

- **Eksperience e meparshme** ne ofrimin e sherbimeve te cateringut gjate organizimeve te ngjashme kulturore apo sportive, veçanërisht me pjesemarrje te femijeve;
- **Aftesi per te ofruar sherbimin sipas kerkesave të përcaktuara nga KOKSH**, përfshirë cilësinë, sasinë dhe afatet kohore;
- **Përgatitja e një oferte të detajuar**, që pasqyron qartë përmbajtjen, çmimin dhe organizimin e shërbimit të kërkuar;
- **Kapaciteti për sigurimin dhe shpërndarjen e ushqimeve**, përfshirë përgatitjen, paketimin dhe dorëzimin në vendngjarje;
- **Sigurimi i një përvoje pozitive për fëmijët**, përmes ofrimit të ushqimeve të sigurta, të shëndetshme dhe të përshtatshme për moshën e tyre;
- **Licencë e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit të cateringut**, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- **Kapacitet logjistik për të operuar në disa qarqe njëkohësisht**, duke garantuar shërbim të pandërprerë dhe efikas gjatë gjithë periudhës së projektit.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 07.03.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.